


**FOL**



# **RAPORTI MBI MONITORIMIN E PUBLIKIMIT TË AKTGJYKIMEVE**



**JANAR – DHJETOR 2021**



**RAPORTI MBI  
MONITORIMIN  
E PUBLIKIMIT TË  
AKTGJYKIMEVE**

JANAR – DHJETOR 2021

Titulli: **Raporti mbi Monitorimin e Publikimit të Aktgjykimeve  
(janar–dhjetor 2021)**

Autore: **Lëvizja FOL**

Monitorues: **Dea Feti, Raesa Nikshiqi, Egzona Bexheti, Nita Azemi,  
Leunora Azemi, Erëza Havolli dhe Emon Ahmet**

Viti i botimit: **Mars 2022**

Publikuar nga: **Lëvizja FOL**

Andrea Gropa nr.35  
Prishtina 10000, Republika e Kosovës  
info@levizjafol.org  
+386 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2022. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Ky projekt mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan, përmes Byrosë Ndërkombëtare për Çështje të Narkotikëve dhe Sundim të Ligjit (INL).

\*Qëndrimet e shprehura në këtë punim jo domosdoshmërisht paraqesin ato të Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL).

# Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive.....	6
2. Metodologjia .....	13
3. Baza ligjore e publikimit të aktgjykimeve .....	14
Gjykata Supreme .....	16
Gjykata e apelit .....	20
Gjykata Themelore e Prishtinës .....	24
Gjykata Themelore e Mitrovicës.....	28
Gjykata Themelore e Pejës.....	32
Gjykata Themelore e Prizrenit .....	36
Gjykata Themelore e Ferizajt.....	40
Gjykata Themelore e Gjilanit.....	44
Gjykata Themelore e Gjakovës .....	48
Rekomandime .....	52
Burimet: .....	53

# 1. Përmbledhja ekzekutive

Publikimi i aktgjykimeve, përveç që është në shërbim të realizimit të obligimeve që rrjedhin nga dispozitat ligjore përkatëse, ajo paraqet edhe një hap të rëndësishëm në respektimin e vlerave të gjyqësisë bashkëkohore. Rrjedhimisht, me qëllim të përmbushjes së këtij misioni, nga janari i vitit 2019 gjykatat janë të obliguara që brenda afatit prej 60 ditësh t'i publikojnë në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së të gjitha aktgjykimet, si akte që shënojnë epilogun e një procesi gjyqësor.

Raporti mbi Monitorimin e Publikimit të Aktgjykimeve (janar-dhjetor 2021) përmban të dhënat që rrjedhin nga monitorimi sistematik i publikimit të aktgjykimeve në ueb-faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë kësaj periudhe një vjeçare.

Ky raport ka për qëllim që të paraqes gjendjen faktike të publikimit të aktgjykimeve nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës, të identifikoj problemet dhe sfidat në publikimin e aktgjykimeve, si dhe të ofroj një listë rekomandimesh për veprimet që organet gjyqësore duhet të ndërmarrin për të përmirësuar shkallën dhe cilësinë e publikimit të aktgjykimeve.

Gjatë monitorimit kemi mbledhur të dhëna mbi numrin e aktgjykimeve të publikuara si dhe cilësinë e publikimit të tyre nga gjykatat. Që nga fillimi i monitorimit është vërejtur një rritje e vazhdueshme e publikimit të tyre nga shtatë gjykatat themelore (përfshirë degët e tyre), Gjykata e Apelit, si dhe Gjykata Supreme. Ndërkaq në vijim do të përshkruajmë disa nga gjetjet kryesore të këtij monitorimi.

- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 në ueb-faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë publikuar gjithsej 24,593 aktgjykime. Ky nivel i publikimit është rritur 31 % në krahasim me vitin paraprak (2020), ku në ueb-faqen e KGJK-së ishin publikuar 18,755 aktgjykime. Duhet të theksohet se në këto shifra nuk janë përfshirë edhe 161 vendime (të cilat gjenden në ueb-faqen e KGJK-së), për shkak se disa prej tyre kanë qenë të përsëritura nga dy e më shumë herë; disa kanë përmbajtur të dhëna të cilat nuk përkonin me të dhënat e listuara në ueb-faqen e KGJK-së; disa kanë qenë aktvendime të publikuara para hyrjes në fuqi të udhëzimit administrativ; si dhe disa kanë qenë procesverbale.
- Tri gjykatat me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe të monitorimit janë: **Gjykata Themelore e Prishtinës** me 5,593 aktgjykime të publikuara; **Gjykata e Apelit** me 3,069 aktgjykime, si dhe **Gjykata Themelore e Mitrovicës** me 3,054 aktgjykime.

- Degët e gjykatave me më së shumti aktgjykime të publikuara janë: **Dega e Vushtrrisë** me 723 aktgjykime, **Dega e Suharekës** me 712 aktgjykime, si dhe **Dega e Rahovecit** me 702 aktgjykime.
- Gjatë kësaj periudhe të monitorimit, *Divizioni i Apelit të Mitrovicës*, si pjesë e Gjykatës së Apelit, nuk kishte publikuar asnjë aktgjykim. Ndërsa nga maji i vitit 2019, ky divizion kishte publikuar gjithsej vetëm 22 aktgjykime (6 prej të cilave në vitin 2020).
- Gjuqtarët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës prijnë me numrin e aktgjykimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe. Gjuqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe janë: **Agron Maxhuni** (nga Gjykata Themelore e Mitrovicës - Dega në Vushtrri) me 334 aktgjykime të publikuara; **Shefqet Baleci** (Gjykata Themelore e Prishtinës-Dega në Drenas) me 291 aktgjykime të publikuara, si dhe **Ferki Xhaferi** (nga Gjykata Themelore e Mitrovicës) me 273 aktgjykime.
- Ueb-faqja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës vazhdon të përballet me probleme të natyrës teknike sa i përket numërimit automatik të aktgjykimeve. Kjo për shkak se, nëse numërohen manualisht në baza mujore të gjitha aktgjykimet e publikuara, numri rezulton të jetë më i lartë, se numri total i aktgjykimeve të numëruara automatikisht nga sistemi i ueb-faqes. Për shembull, në Gjykatën Supreme në total figurojnë 2,200 aktgjykime, ndërsa nëse numërohen aktgjykimet e publikuara në baza mujore, figurojnë 2,232 aktgjykime. Gjithashtu gjatë monitorimit FOL ka hasur edhe në aktgjykime me numra identik të lëndëve, e të cilat në përmbajtje kanë qenë komplet të ndryshme.
- Shtatë gjykatat themelore kanë publikuar dukshëm më shumë aktgjykime të natyrës penale, ndërsa Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit prijnë me publikimin e aktgjykimeve civile. Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara gjatë këtij viti, 12,282 aktgjykime (apo 50 %) janë aktgjykime të natyrës penale; 9,735 janë aktgjykime të natyrës civile (afër 40 %); 2,348 janë administrative (afër 10 %) dhe vetëm 202 aktgjykime janë për çështje ekonomike (afër 1 %).
- Gjatë kësaj periudhe një vjeçare janë publikuar vetëm 65 aktgjykime në lidhje me veprat penale të korrupsionit, si dhe 1,004 aktgjykime të dhunës me bazë gjinore. Pra publikimi i aktgjykimeve të korrupsionit vazhdon të jetë ende i ulët, ndërsa në krahasim me vitin paraprak është dyfishuar publikimi i aktgjykimeve me bazë në dhunë gjinore.
- Gjatë kësaj periudhe të monitorimit, zbatimi i Vendimit të KGJK-së për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve nga shtatë gjykatat themelore është evidentuar në 17,665 aktgjykime, apo në 92% të aktgjykimeve të publikuara nga shtatë gjykatat themelore (19,292 aktgjykime). Ndërsa në pjesën tjetër prej 1,549 aktgjykimesh, përkatësisht në 8 % prej tyre, janë vërejtur lëshime në zbatimin e këtij vendimi. Më së shumti lëshime janë evidentuar në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, ku janë evidentuar gjithsej 739 aktgjykime të publikuara pa respektimin e kërkesave të këtij vendimi.

- Gjatë kësaj periudhe, pjesa më e madhe e aktgjykimeve, apo 22,666 prej tyre (92 %) janë publikuar në gjuhën shqipe, ndërsa 1,927 aktgjykime (8 %) janë publikuar në gjuhën serbe. Pjesa më e madhe e aktgjykimeve në gjuhën serbe janë publikuar nga Gjykata Themelore e Mitrovicës (1,406 aktgjykime), ndërsa Gjykata Themelore e Pejës, Prizrenit dhe e Gjakovës gjatë kësaj periudhe nuk kanë publikuar asnjë aktgjykim në gjuhën serbe.
- Prej numrit të përgjithshëm të aktgjykimeve të publikuara gjatë këtij viti, 445 aktgjykime (2 %) janë publikuar pa fshehje të të dhënave personale palëve apo subjekteve të tjera të nevojshme në bazë të udhëzimit administrativ, ndërsa në pjesën prej 24,148 aktgjykimesh (98 %) të dhënat personale janë anonimizuar në tërësi. Numri i aktgjykimeve të paanonizuara është rritur ndjeshëm krahasuar me periudhën janar-dhjetor 2020, ku ishin publikuar 353 aktgjykime të paanonizuara. Numrin më të madh të aktgjykimeve pa ua fshehur të dhënat personale gjatë vitit 2021 i ka publikuar Gjykata Themelore e Prizrenit (140 aktgjykime). Më së shumti lëshime në fshehjen e të dhënave personale janë evidentuar në fshehjen të dhënave të ekspertëve, dëshmitarëve, të tabelave të regjistrimit të automjetit, apo të ndonjë dokumenti tjetër personal. Ndonëse në dispozitive të aktgjykimeve këto të dhëna ishin fshehur në tërësi, lëshime në fshehjen e tyre janë vërejtur gjatë pjesës së arsyetimeve.
- Sa i përket respektimit të afatit ligjor për publikimin e aktgjykimeve, është vërejtur se gjykatave u janë dashur mesatarisht 71 ditë për t'i publikuar aktgjykimet në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së, llogaritur nga dita e shpalljes së tyre. Kjo mesatare bie ndesh me kohën e paraparë me Ligjin për Gjykatat, ku thuhet *"Gjykatat publikojnë të gjitha aktgjykimet në faqen e tyre zyrtare të internetit, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit, në pajtim me legjislacionin në fuqi"*.

Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhënat e përgjithshme në lidhje me numrin e aktgjykimeve të publikuara në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 nga të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës.



**TABELA 1** Aktgjykimet e publikuara nga të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës gjatë periudhës janar - dhjetor 2021.

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	TOTAL
Gjykata Supreme	131	134	177	119	184	103	121	188	245	207	278	345	2232
Gjykata e Apelit	91	81	115	107	45	134	140	270	243	400	602	841	3069
Gjykata Themelore e Prishtinës	342	296	243	320	388	405	432	415	746	480	668	858	5593
Gjykata Themelore e Ferizajt	148	142	195	216	237	256	174	194	195	207	240	305	2509
Gjykata Themelore e Mitrovicës	165	96	150	116	120	157	142	46	690	441	355	576	3054
Gjykata Themelore e Prizrenit	120	212	265	233	197	194	102	85	174	197	215	286	2280
Gjykata Themelore e Gjakovës	205	152	248	203	184	179	158	191	240	176	161	349	2446
Gjykata Themelore e Pejës	302	252	200	307	235	166	195	106	11	169	141	105	2189
Gjykata Themelore e Gjilanit	124	44	91	118	33	54	60	0	73	140	275	209	1221
<b>TOTAL</b>	<b>1,628</b>	<b>1,409</b>	<b>1,684</b>	<b>1,739</b>	<b>1,623</b>	<b>1,648</b>	<b>1,524</b>	<b>1,495</b>	<b>2,617</b>	<b>2,417</b>	<b>2,935</b>	<b>3,874</b>	

Lëvizja FOL monitorimin sistematik të publikimit të aktgjykimeve në ueb-faqen e KGJK-së e ka filluar qysh në muajin maj të vitit 2019. Që nga kjo kohë është vërejtur rritje e theksuar e publikimit të aktgjykimeve. Kjo mund të vërtetohet me faktin se gjatë periudhës maj 2019–dhjetor 2020, *periudhë kjo gati 2 vjeçare*, Gjykatat e Republikës së Kosovës në ueb-faqen e KGJK-së kishin publikuar gjithsej 29,001 aktgjykime.

**TABELA 2** Aktgjykimet e publikuara nga të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës gjatë periudhës maj 2019 - dhjetor 2020.

	Viti 2019									Janar	Viti 2020									
	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Shkurt		Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Gjykata Supreme	1	67	114	8	14	63	148	53	124	130	81	0	88	277	42	109	189	237	110	238
Gjykata e Apelit	392	80	198	90	204	144	238	200	154	220	120	43	62	242	202	150	113	149	139	138
Gjykata Themelore e Prishtinës	152	34	166	115	24	74	241	909	435	498	226	255	316	451	358	311	287	658	395	344
Gjykata Themelore e Ferizajt	72	224	296	100	200	217	165	215	244	224	203	105	39	63	152	204	112	189	196	206
Gjykata Themelore e Mitrovicës	0	0	163	64	45	341	394	345	271	143	70	0	0	51	230	77	203	516	107	242
Gjykata Themelore e Prizrenit	63	79	149	130	298	219	259	485	417	463	219	244	137	212	70	287	190	141	154	204
Gjykata Themelore e Gjakovës	16	95	148	120	166	159	159	169	281	176	79	8	86	115	177	102	138	200	216	164
Gjykata Themelore e Pejës	35	27	46	9	150	143	159	99	143	103	44	0	31	94	65	102	206	318	159	125
Gjykata Themelore e Gjilanit	0	0	0	38	75	86	44	51	104	134	117	43	43	125	95	98	92	95	41	160
<b>TOTAL</b>	<b>731</b>	<b>606</b>	<b>1,280</b>	<b>674</b>	<b>1,176</b>	<b>1,446</b>	<b>1,807</b>	<b>2,526</b>	<b>2,173</b>	<b>2,091</b>	<b>1,159</b>	<b>698</b>	<b>802</b>	<b>1,630</b>	<b>1,391</b>	<b>1,440</b>	<b>1,530</b>	<b>2,503</b>	<b>1,517</b>	<b>1,821</b>

Prej këtyre aktgjykimeve, 10,246 aktgjykime ishin publikuar në periudhën maj–dhjetor 2019, ndërsa 18,755 aktgjykime në periudhën janar–dhjetor 2020.<sup>1</sup> Pra këto shifra dëshmojnë qartë shumëfishimin e trendit të publikimit të aktgjykimeve nga Gjykatat e Republikës së Kosovës.

Niveli i përgjithshëm i publikimit të aktgjykimeve që nga fillimi i monitorimit të publikimit të tyre nga Lëvizja FOL, përkatësisht prej muajit maj 2019 deri në dhjetor 2020, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

<sup>1</sup> Për të pasqyruar edhe më mirë këtë rritje, duhet të theksohet se nga 1 janari 2016 deri në muajin prill 2019 (periudhë kjo 3 vjeçare) në ueb-faqen e KGJK-së ishin publikuar 9,061 aktgjykime.

Totali i aktgjykimeve të publikuara nga Gjykatat e Republikës së Kosovës gjatë periudhës janar - dhjetor 2021



## 2. Metodologjia

Lëvizja FOL për përpilimin e të dhënave të këtij raporti ka përdorur metodën e monitorimit të vazhdueshëm sistematik, pra monitorimin ditor të ueb-faqes zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Të gjitha gjykatat janë informuar paraprakisht përmes postës elektronike se ato do të jenë subjekt i monitorimit për numrin dhe dinamikën e publikimit të aktgjykimeve, si dhe nëse publikimi i aktgjykimeve ndjek kërkesat e veçanta të ligjit, të udhëzimeve administrative dhe të vendimeve tjera relevante. Të dhënat e mbledhura nga ky proces i monitorimit janë paraqitur për çdo muaj në formë infografikash dhe janë publikuar në rrjetet sociale të Lëvizjes FOL.

Lëvizja FOL gjatë monitorimit të aktgjykimeve vëmendje të veçantë i ka kushtuar edhe gjyqtarëve që kanë publikuar më shumë aktgjykime. Në lidhje me këtë, FOL ka listuar nga 3 gjyqtarë të secilës gjykatë me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë periudhës janar–dhjetor 2021.

Nga aktgjykimet e publikuara, Lëvizja FOL ka krijuar një databazë me të dhëna. Rrjedhimisht, aktvendimet (deri në hyrjen në fuqi të udhëzimit të ri administrativ), si dhe aktgjykimet e njëjta të evidentuara gjatë kësaj periudhe nuk janë bashkangjitur në këtë databazë.

Kjo databazë, ndër të tjera, përfshin:

- numrin e përgjithshëm të aktgjykimeve të publikuara nga çdo gjykatë, për çdo muaj;
- nivelin e respektimit të protokolleve dhe afateve të përcaktuara për publikimin e vendimeve, si dhe pajtueshmëria e aktgjykimeve të publikuara me Ligjin për Gjykatat dhe udhëzimet administrative;
- mbrojtjen e të dhënave personale të palëve dhe specifikat tjera të cilat rregullohen me ligj dhe me Udhëzimin Administrativ nr.04/2019 për publikimin e aktgjykimeve të përpunuara.
- gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti aktgjykime;
- nivelin e zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve;
- gjuhën në të cilën janë publikuar aktgjykimet, si dhe
- formatin, llojin dhe natyrën e aktgjykimeve të publikuara.

Në fund të raportit, FOL ka dhënë edhe një sërë rekomandimesh për institucionet relevante, jetësimi i të cilave do të kontribuonte në rritjen e transparencës dhe në minimizimin e gabimeve gjatë publikimit të aktgjykimeve.

### 3. Baza ligjore e publikimit të aktgjykimeve

Transparenca e institucioneve shtetërore si koncept nënkupton udhëheqjen në bazë të parimeve të demokracive të konsoliduara bashkëkohore. Sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës i nevojitet krijimi i kushteve për garantimin e transparencës institucionale, si parakusht i domosdoshëm drejt ndërtimit të një besueshmërie të lartë ndaj institucioneve të saj. Ndarja e drejtësisë nga ana e gjykatës është mision në vete, që nuk është e plotë pa ekzistimin e transparencës dhe publicitetit mbi punën e gjykatave. Vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet forcimi i sigurisë juridike në procesin e gjykimit, ngritja e nivelit të besueshmërisë së publike, si dhe betonimi i parimeve bazë të gjykatave bashkëkohore.

Gjykimi publik garantohet edhe me dispozitat e *Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore*, e cila në nenin 6 paragrafin 1 parashikon se çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm.

Parimi i gjykimit publik, pra gjykimit me dyer të hapura, është inkorporuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës<sup>2</sup>, ku në nenin 31 të saj parashihet se gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata konsideron se në të mirë të drejtësisë është i domosdoshëm përjashtimi i publikut.

Për të përmbushur sa më mirë këtë mision, *Ligji për Gjykatat (Nr. 06/L-054)*<sup>3</sup> që u miratua në dhjetor të vitit 2018 dhe që është aktualisht në fuqi, ka bërë progres në rritjen e transparencës së gjyqësorit, duke e bërë të detyrueshme për të gjitha gjykatat publikimin e të gjitha aktgjykimeve brenda 60 ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit në faqet e tyre të internetit. Kjo është paraparë në paragrafin 3 të nenit 6 të këtij ligji.

Për dallim nga dispozitat e ligjit aktual, *Ligji për Gjykatat (Nr. 03/L-199)* që paraprakisht ka qenë në fuqi, i obligonte gjykatat të publikojnë aktgjykimet e plotfuqishme në faqet e tyre zyrtare të internetit, në afat kohor prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e arritjes së plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Kjo nënkupton se në raport me ligjin e mëparshëm, ligji aktual ka bërë progres duke e zgjeruar gamën e vendimeve gjyqësore që duhet të publikohen. Pra, përveç aktgjykimeve të plotfuqishme, tashmë duhet të publikohen edhe ato vendime që nuk e kanë fituar ende plotfuqishmërinë ligjore.

Për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë publikimit të aktgjykimeve, Këshilli Gjyqësor i Kosovës në fund të vitit 2019 ka nxjerrë Udhëzimin e ri Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara<sup>4</sup> dhe Manualin për Publikimin dhe Përpunimin e Aktgjykimeve<sup>5</sup>. Në fund të vitit 2021 ky udhëzim pësoj disa ndryshime. Përkatësisht, në dhjetor të vitit 2021, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nxjerrë *Udhëzimin Administrativ nr. 01/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 04/2019 për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara*.<sup>6</sup> Si një prej ndryshimeve esenciale të parapara në këtë ndryshim/plotësim, ishte se përveç aktgjykimeve, gjykatat obligohen të publikojnë edhe aktvendimet, përkatësisht aktvendimet meritore. Pra, ndryshe nga Udhëzimi

2 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 31.

3 Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat, 2018, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

4 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2019 për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara, 2019

5 Po aty.

6 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Udhëzimi Administrativ nr. 01/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 04/2019 për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara*, 2021.

Administrativ që ka qenë në fuqi, tashmë përcaktohet edhe mënyra e publikimit të aktvendimeve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, si edhe publikimi i aktvendimeve meritore të gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.

Udhëzimi Administrativ në fuqi, me ndryshim/plotësimet e bëra, obligon gjykatat t'i publikojnë të gjitha aktgjykimet në ueb-faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me përjashtim të *aktgjykimeve penale në të cilën përfshihen personat e mitur në çfarëdo cilësie, aktgjykimet në kontestet martesore, aktgjykimet për mbajtje financiare dhe ushqimi, vërtetim apo kundërshtim të atësisë, dhe kujdestari të personit të mitur, si dhe aktgjykimet për kundërvajtje.*<sup>7</sup>

Ndërkaq sa i përket aktvendimeve, gjykatat themelore obligohen të publikojnë të gjitha aktvendimet meritore, përveç *aktvendimeve për adoptim, aktvendimeve për heqjen dhe kthimin e zotësisë për të vepruar, për vendosjen dhe mbajtjen e të sëmurit psikik në institucionin shëndetësor, aktvendimet me të cilat ndryshohet masa e trajtimit psikiatrik në liri apo në institucionet e kujdesit shëndetësor në ndalim, aktvendimet për pushimin dhe vazhdimin e të drejtës prindërore, për dhënien e lejes për lidhjen e martesës, aktvendimet e rasteve të dhunës në familje dhe për masat sigurose në çështjet familjare, si dhe në rastet e seancave të mbyllura dhe rastet tjera të parapara me legjislacionin në fuqi.*<sup>8</sup>


Për çështjen e anonimizimit të aktgjykimeve, sipas këtij udhëzimi, përgjegjës është bashkëpunëtori profesional apo zyrtari ligjor në secilën gjykatë dhe degë të saj, i caktuar nga kryetari i gjykatës përkatëse. Aktgjykimet, sipas udhëzimit, duhet të publikohen në afat prej 60 ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimet. Po ashtu nga ky udhëzim kërkohet që aktgjykimet të vendosen në ueb-faqe në formatin PDF.

Për të përmirësuar cilësinë e aktgjykimeve dhe për tu siguruar që ato ti përmbajnë elementet thelbësore, Këshilli Gjyqësor i Kosovës në vitin 2018 nxori *Vendimin për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve dhe krijoi grupin punues për krijimin e shabloneve për standardizimin e formave.* Në këto shablone janë paraqitur format e të gjitha aktgjykimeve penale dhe civile dhe ndër të tjera kërkohet që në fillim të aktgjykimet të vendoset Emblema e Republikës së Kosovës, dhe që numri unik i lëndës të vendoset në anën e djathtë të tij etj..

Përmes këtij vendimi është synuar shtimi i efikasitetit, përmirësimi i konsistencës së publikimit të aktgjykimeve, përmirësimi i cilësisë së aktgjykimeve, duke siguruar që ato t'i përmbajnë elementet thelbësore.

7 Udhëzimi Administrativ nr. 04/2019 për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara, neni 2.

8 Udhëzimi Administrativ nr. 01/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 04/2019 për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara, neni 5.



# Gjykata Supreme



## 2,232


GJITHSEJ AKTGJYKIME

Gjykata Supreme, duke përfshirë Kolegjin e Apelit dhe Dhomën e Posaçme, gjatë periudhës janar - dhjetor 2021 ka publikuar gjithsej 2,232 aktgjykime<sup>9</sup>. Ky nivel i publikimit dëshmon rritje të theksuar në krahasim me aktgjykimet e publikuara gjatë periudhës janar - dhjetor 2020<sup>10</sup>, ku Gjykata Supreme kishte publikuar 1,625 aktgjykime, apo 29 % më pak se në vitin 2021.

Në figurën e mëposhtme është pasqyruar niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Gjykata Supreme gjatë periudhës janar - dhjetor të vitit 2021.

FIGURA 1

Niveli i publikimit të aktgjykimeve në ueb - faqen e KGJK - së nga Gjykata Supreme gjatë periudhës janar - dhjetor 2021




<sup>9</sup> Nëse shikohet numri total i aktgjykimeve të publikuara në ueb-faqe brenda vitit 2021, në Gjykatën Supreme figurojnë 2,200 aktgjykime. Ndërsa nëse numërohen në baza mujore, rezulton numri i njëjtë si në data bazën e FOL-it.

<sup>10</sup> Për më tepër, shih: Raporti për publikimin e aktgjykimeve, Lëvizja FOL, janar - dhjetor 2020.

Kontribut të madh në këtë nivel të publikimit të aktgjykimeve kanë shënuar edhe Dhoma e Posaçme dhe Kolegji i Apelit. **Dhoma e Posaçme** gjatë kësaj periudhe ka publikuar 1,357 aktgjykime, përkatësisht 49% më shumë se në vitin 2020 (910 aktgjykime). Ndërsa **Kolegji i Apelit** gjatë vitit 2021 ka publikuar 34 aktgjykime, numër ky që në raport me vitin 2020 (236 aktgjykime) kishte pësuar ulje të theksuar, përkatësisht 79%.<sup>11</sup>

Publikimi i aktgjykimeve nga Dhoma e Posaçme dhe Kolegji i Apelit për çdo muaj gjatë vitit 2021, në mënyrë grafike është paraqitur në figurën e mëposhtme.



**FIGURA 2**

Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Dhoma e Posaçme dhe Kolegji i Apelit gjatë periudhës janar – dhjetor 2021

<sup>11</sup> Po aty.



Siç shihet në tabelën e mësipërme, Kolegji i Apelit gjatë 8 muajve (janar, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor dhe nëntor) nuk ka publikuar asnjë aktgjykim. Niveli i publikimit të Kolegjit të Apelit gjatë kësaj periudhe është ulur në mënyrë të theksuar në raport me vitin 2020, ku ky divizion kishte publikuar gjithsej 163 aktgjykime.

Pjesa më e madhe e aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Supreme (përfshirë Kolegjin e Apelit dhe Dhomën e Posaçme) janë të natyrës civile, respektivisht 1,297 aktgjykime civile (58 %), ndërsa 575 prej tyre janë të natyrës administrative (26 %), 310 aktgjykime të natyrës penale (14 %), si dhe vetëm 50 aktgjykime për çështje ekonomike (2 %).

Në grafikën në vijim është paraqitur lloji i aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Supreme gjatë periudhës janar–dhjetor 2021.



Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë gjatë kësaj periudhe të monitorimit, Gjykata Supreme ka publikuar vetëm 4 aktgjykime në lidhje me veprat penale të korrupsionit dhe 11 aktgjykime të dhunës me bazë gjinore. Pra publikimi i aktgjykimeve të këtyre natyrave nga kjo gjykatë vazhdon të jetë i ulët.

Ndërsa sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar, 2,044 aktgjykime apo 91 % e tyre janë publikuar në gjuhën shqipe, ndërsa pjesa tjetër prej 188 aktgjykimesh apo 9 % janë publikuar në gjuhën serbe.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë grafike gjuha e aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Supreme e Kosovës gjatë vitit 2021.



Ndërsa lëshime në zbatimin e Udhëzimit Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara, përkatësisht në pjesën ku bëhet fjalë për përpunimin e të dhënave personale, janë gjetur vetëm në 19 aktgjykime, apo vetëm në 1% të aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë. Ndërkaq në pjesën tjetër të aktgjykimeve, ky udhëzim është zbatuar në tërësi.

Nga analiza e respektimit të afateve ligjore për publikim të aktgjykimeve të Gjykatës Supreme në ueb-faqen e KGJK-së, është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 48 ditë për ti publikuar aktgjykimet nga dita e shpalljes së tyre. Kjo nënkupton se kjo mesatare e publikimit të aktgjykimeve nga kjo gjykatë është në harmoni me nenin 6 të Ligjit për Gjykatat, ku kërkohet që aktgjykimet të publikohen në ueb-faqen zyrtare 60 ditë pas shpalljes.

Ndërkaq gjyqtarët e Gjykatës Supreme me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2021, si dhe numri i aktgjykimeve të publikuar nga ana e tyre, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

**FIGURA 5** Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara nga Gjykata Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2021





# Gjykata e Apelit




## 3,069

GJITHSEJ AKTGJYKIME

Gjykata e Apelit, duke përfshirë Divizionin e Apelit të Mitrovicës, gjatë periudhës janar - dhjetor 2021 ka publikuar gjithsej 3,069 aktgjykime, apo 77 % më shumë se në vitin 2020 (1,732 aktgjykime). Kjo dëshmon rritje të madhe të numrit të aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë, në raport me nu mrin e aktgjykimeve të publikuara në vitin paraprak. Madje me këto shifra, gjatë kësaj periudhe të monitorimit kjo gjykatë renditet e dyta për nga niveli i publikimit të aktgjykimeve (pas Gjykatës Themelore të Prishtinës).

Në figurën e mëposhtëm është paraqitur niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Gjykata e Apelit gjatë periudhës janar - dhjetor 2021.

FIGURA 6 Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Gjykata e Apelit gjatë periudhës janar - dhjetor 2021



Ashtu siç shihet në tabelën e vendosur më sipër, trendi i publikimit të aktgjykimeve nga Gjykata e Apelit ka vazhduar të rritet periodikisht në baza mujore, gjatë tërë periudhës kalendarike të vitit 2021.

Ndërkaq ndryshe nga periudha janar–dhjetor 2020, ku **Divizioni i Apelit të Mitrovicës** kishte publikuar 12 aktgjykime, gjatë vitit 2021 ky divizion nuk kishte publikuar asnjë aktgjykim.

Ndërsa sa i përket llojit të lëndëve të publikuara, edhe Gjykata e Apelit ka publikuar më shumë aktgjykime të natyrës civile. Nga totali i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara, 1,950 prej tyre janë për çështje civile (64 %) , 778 sosh për çështje penale (25 %), 309 për çështje administrative (10 %), ndërsa vetëm 32 aktgjykime për çështje ekonomike (1%).

Në grafikën e mëposhtme është përshkruar publikimi i aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit, të ndarë sipas llojit të lëndëve.



Sa i përket natyrës së aktgjykimeve të publikuar, Gjykata e Apelit gjatë kësaj periudhe ka publikuar 17 aktgjykime për veprat penale të korrupsionit dhe 20 aktgjykime në lidhje me dhunën me bazë gjinore.

Ndërsa sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar aktgjykimet, Gjykata e Apelit ka publikuar 92 aktgjykime në gjuhën serbe, apo 3%, ndërsa pjesa tjetër prej 2,977 aktgjykimesh janë publikuar në gjuhën shqipe (97%).

Gjuha në të cilën janë publikuar aktgjykimet e Gjykatës së Apelit gjatë vitit 2021 është paraqitur në figurën e mëposhtme.



Udhëzimi Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara është zbatuar në mënyrë të plotë në pothuajse të gjitha aktgjykimet e Gjykatës së Apelit të publikuara gjatë kësaj periudhe. Nga numri total i aktgjykimeve të publikuara, respektivisht nga 3,069 aktgjykime, vetëm 1 aktgjykim është publikuar pa u anonimizuar. Kjo dëshmon përgjegjësinë dhe përkushtimin e madh të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të kësaj gjykate që merren me publikimin e aktgjykimeve për fshehjen e të dhënave personale.

Nga analiza e respektimit të afateve ligjore për publikimin e aktgjykimeve nga Gjykata e Apelit, është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 89 ditë për ti publikuar të gjitha aktgjykimet në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së, llogaritur nga dita e shpalljes. Kjo nënkupton se kjo mesatare e tejkalon kohën e paraparë me Ligjin për Gjykatat për publikimin e aktgjykimeve.

Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara nga Gjykata e Apelit gjatë kësaj periudhe janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

**FIGURA 9** Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën e Apelit gjatë periudhës janar - dhjetor 2021





Nga analiza e respektimit të afateve ligjore për publikimin e aktgjykimeve nga Gjykata e Apelit, është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 89 ditë për ti publikuar të gjitha aktgjykimet në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së, llogaritur nga dita e shpalljes. Kjo nënkupton se kjo mesatare e tejkalon kohën e paraparë me Ligjin për Gjykatat për publikimin e aktgjykimeve.



# Gjykata Themelore e Prishtinës



## 5,593

GJITHSEJ AKTGJYKIME


Gjykata Themelore e Prishtinës, duke përfshirë 4 degët e saj (Dega në Podujevë, Dega në Graçanicë, Dega në Lipjan dhe Dega në Glllogoc) është gjykata me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë periudhës janar–dhjetor 2021. Gjatë kësaj periudhe kjo gjykatë ka publikuar 5,593 aktgjykime<sup>12</sup>, apo 23 % më shumë se në vitin 2020<sup>13</sup>, ku kjo gjykatë kishte publikuar 4,534 aktgjykime.

Duhet të theksohet se ky numër është shumëfishuar edhe në krahasim me vitin 2019, ku kjo gjykatë në ueb-faqen zyrtare të saj kishte publikuar vetëm 1,912 aktgjykime. Pra statistikave të viteve të fundit tregojnë për rritjen e transparencës dhe vetëdijesimin e zyrtarëve të kësaj gjykate lidhur me rëndësinë e publikimit të aktgjykimeve. Dihet se Gjykata Themelore e Prishtinës përballet me fluksin më të madh të lëndëve, për shkak se kjo gjykatë përbëhet edhe nga tri departamente shtesë (Departamenti Special, Departamenti për Çështje Administrative dhe Departamenti për Çështje Ekonomike), të cilat kanë kompetencë territoriale në tërë territorin e Republikës së Kosovës, prandaj është i kuptueshëm niveli më i lartë i publikimit të aktgjykimeve në raport me gjykatat tjera.

Në grafikën në vijim janë paraqitur të dhënat mbi numrin e aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë periudhës janar–dhjetor 2021.

FIGURA 10

Niveli i publikimit të aktgjykimeve në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar–dhjetor 2021




<sup>12</sup> Në ueb-faqen zyrtare figurojnë 5,724 aktgjykime të publikuara nga kjo gjykatë, përkatësisht 131 aktgjykime më pak se sa figurojnë në databazën e FOL të nxjerrë nga monitorimi. Largimi i tyre nga databaza është bërë për shkak se, 33 aktgjykime kanë qenë të përsëritura, 88 aktgjykime janë evidentuar të publikuara në atë mënyrë që nuk përkohjnë me përmbajtjen e aktgjykimit të bashkangjitur, 9 aktvendime (të publikuara para hyrjes së udhëzimit të ri administrative në fuqi), si dhe 1 procesverbal.

<sup>13</sup> Për më tepër, shih: Raporti për publikimin e aktgjykimeve, Lëvizja FOL, 2021.

Në këtë numër të madh të publikimit, në masë të madhe kanë kontribuar edhe degët e kësaj gjykate. **Dega e Podujevës** gjatë kësaj periudhe ka publikuar 559 aktgjykime, **Dega e Lipjanit** 498 aktgjykime, **Dega e Glllogocit** 318 aktgjykime dhe **Dega e Graçanicës** 76 aktgjykime.

Niveli i publikimit të degëve të Gjykatës Themelore në Prishtinë në mënyrë grafike është paraqitur edhe në figurën në vijim.



**FIGURA 11** Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar - dhjetor 2021.

Ndërkaq sa i përket natyrës së aktgjykimeve të publikuara, ndryshe nga Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit, kjo gjykatë prinë me publikimin e aktgjykimeve të natyrës penale. Respektivisht, nga numri i përgjithshëm i publikimit, 2,333 aktgjykime janë të natyrës penale (41 %), 1,669 të natyrës civile (30 %), 1,471 prej tyre administrative (26 %) dhe 120 aktgjykime për çështje ekonomike (2 %).


Lloji i aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë kësaj periudhe është pasqyruar edhe në grafikën e mëposhtme.





Nga aktgjykimet penale, 7 aktgjykime janë për veprat penale të keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar dhe 278 aktgjykime të dhunës me bazë gjinore.


Gjykata Themelore në Prishtinë, përfshirë degët, gjatë periudhës monitoruese ka publikuar vetëm 12 aktgjykime në gjuhën serbe, apo 0.21 %, ndërsa pjesa tjetër e aktgjykimeve janë publikuar në gjuhën shqipe. Në mënyrë grafike, gjuha e aktgjykimeve të publikuara është paraqitur edhe në figurën e mëposhtme.



Në zbatimin e Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve janë vërejtur lëshime në 316 aktgjykime të publikuara nga kjo gjykatë (6 %). Ndërsa në pjesën tjetër prej 5,277 aktgjykimesh (94 %), ky vendim është zbatuar në tërësi.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë grafike zbatimi i këtij vendimi në aktgjykimet e publikuara të kësaj gjykate.

**FIGURA 14** Niveli i zbatimit të Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë periudhës janar - dhjetor 2021.



Ndërkaq sa i përket fshehjes së të dhënave personale në aktgjykimet e publikuara duhet të theksohet se kjo është ndër gjykatat me më së shumti lëshime të evidentuara. Nga aktgjykimet e publikuara gjatë vitit 2021 nga kjo gjykatë, 120 aktgjykime janë publikuar pa ua fshehur të dhënat personale subjekteve që kërkohet në bazë të udhëzimit administrativ. Më së shumti lëshime në këtë drejtim janë evidentuar në fshehjen të dhënave personale të ekspertëve, dëshmitarëve, të tabelave të regjistrimit të automjetit, apo të ndonjë dokumenti tjetër personal.

Nga analizimi i respektimit të afatit ligjor për publikimin e aktgjykimeve nga dita e shpalljes, është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 100 ditë për ti publikuar aktgjykimet në ueb-faqen e KGJK-së. Kjo nënkupton se Gjykata Themelore e Prishtinës e tejkalon dukshëm afatin për publikimin e aktgjykimeve, të paraparë në Ligjin për Gjykatat.

Gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti aktgjykime në Gjykatën Themelore në Prishtinë gjatë periudhës janar-dhjetor 2021, si dhe numri i aktgjykimeve të publikuara nga ana e tyre, është paraqitur në grafikonin në vijim.

**FIGURA 15** Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar - dhjetor 2021





# Gjykata Themelore e Mitrovicës




**3,054**

GJITHSEJ AKTGJYKIME

Gjykata Themelore e Mitrovicës, duke përfshirë katër degët e saj (Skenderajn, Vushtrrinë, Leposaviqin dhe Zubin Potokun) gjatë periudhës janar - dhjetor 2021 në ueb-faqe zyrtare kanë publikuar gjithsej 3,054 aktgjykime, numër ky që në raport me numrin e aktgjykimeve të publikuara në vitin 2020 (1,910 aktgjykime), ka shënuar rritje për 60%. Me këtë nivel të publikimit, kjo gjykatë hyn në radhën e tri gjykatave me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe.

Publikimi i aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar - dhjetor 2021, në mënyrë grafike është shfaqur në figurën e mëposhtme.

FIGURA 16 Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar - dhjetor 2021



Siç shihet edhe në grafikonin e vendosur më sipër, niveli i publikimit të aktgjykimeve nga kjo gjykatë është rritur në mënyrë të dukshme në 4 muajt e fundit të vitit.

Gjatë kësaj periudhe, **Dega e Vushtrrisë** ka publikuar 723 aktgjykime, **Dega e Skenderajt** ka publikuar 249 aktgjykime, **Dega e Leposaviqit** ka publikuar 76 aktgjykime, ndërsa **Dega e Zubin Potokut** 70 aktgjykime. Bazuar në këto shifra, Dega e Vushtrrisë renditet si dega me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe.

Duhet të theksohet se disa prej degëve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë gjatë kësaj periudhe nuk kanë publikuar asnjë aktgjykim për disa muaj me radhë. Fjala është për Degën në Zubin Potok dhe Degën në Leposaviq, të cilat për 9 muaj nuk kanë publikuar asnjë aktgjykim.

Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore në Mitrovicë është shfaqur grafikisht në tabelën e mëposhtme.






	 Skenderaj	 Vushtrri	 Leposaviq	 Zubin Potok
Janar	12	25	0	0
Shkurt	13	22	0	0
Mars	23	24	0	0
Prill	26	18	0	0
Maj	20	26	0	0
Qershor	22	23	0	34
Korrik	13	24	0	0
Gusht	15	14	0	0
Shtator	0	265	32	0
Tetor	47	65	31	19
Nëntor	23	136	0	8
Dhjetor	35	81	13	9

FIGURA 17

Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës gjatë periudhës janar - dhjetor 2021

Pjesa më e madhe e aktgjykimeve të publikuara janë të natyrës penale, përkatësisht 2,209 aktgjykime penale, apo 72%, ndërsa 845 aktgjykime, apo 27%, janë të natyrës civile. Në grafikën në vijim është paraqitur natyra e aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2021.



Nga aktgjykimet penale, kjo gjykatë gjatë kësaj periudhë ka publikuar vetëm 5 aktgjykime të korrupsionit dhe 112 aktgjykime me dhunë në bazë gjinore. Pra, ndonëse niveli i publikimit të aktgjykimeve me bazë në dhunë gjinore nga kjo gjykatë ishte i lartë, publikimi i aktgjykimeve të korrupsionit mbetet shumë i ulët.

Për dallim nga gjykatat e tjera, publikimi i aktgjykimeve në gjuhën serbe në Gjykatën Themelore në Mitrovicë është më i madh. Nga 3,054 aktgjykime të publikuara në tërësi nga kjo gjykatë, 1,406 aktgjykime apo 46 % të tyre janë në gjuhën serbe, ndërsa 1,648 aktgjykimet tjera apo 54% janë publikuar në gjuhën shqipe.

Në grafikën e mëposhtme është paraqitur gjuha në të cilën janë publikuar aktgjykimet në Gjykatën Themelore të Mitrovicës gjatë kësaj periudhe të monitorimit.




Duhet të theksohet se Gjykata Themelore e Mitrovicës ka arritur ta respektoj në mënyrë të konsiderueshme Udhëzimin Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës sa i përket fshehjes së të dhënave personale. Lëshime në respektimin e këtij udhëzimi janë evidentuar në 30 aktgjykime të kësaj gjykate.

Sa i përket zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve, nga të gjitha aktgjykimet e publikuara nga kjo gjykatë dhe degët e saj, lëshime janë gjetur në 739 aktgjykime (27%). Pra kjo është gjykata me më së shumti lëshime të evidentuara në zbatimin e këtij vendimi.

Në tabelën e mëposhtme, në mënyrë grafike është shfaqur niveli i zbatimit të këtij vendimi nga Gjykata Themelore e Mitrovicës për secilin muaj gjatë kësaj periudhe.

FIGURA 20

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në aktgjykimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë vitit 2021



Nga analizimi i respektimit të afatit ligjor për publikimin e aktgjykimeve nga dita e shpalljes së tyre, është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 92 ditë për t'i publikuar aktgjykimet në ueb faqen e KGJK-së. Kjo nënkupton se edhe Gjykata Themelore e Mitrovicës e tejkalon dukshëm afatin 60 ditorë për publikimin e aktgjykimeve, të paraparë në Ligjin për Gjykatat.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara, si dhe numri i aktgjykimeve të publikuara nga ana e tyre, gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 në Gjykatën Themelore të Mitrovicës.

FIGURA 21

Gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti aktgjykime në Gjykatën Themelore të Mitrovicës gjatë periudhës janar – dhjetor 2021





# Gjykata Themelore e Pejës




**2,189**

GJITHSEJ AKTGJYKIME

Gjykata Themelore e Pejës, duke përfshirë tri degët e saj (Deçanin, Istogun dhe Klinën) gjatë periudhës janar - dhjetor 2021 ka publikuar 2,189 aktgjykime.<sup>14</sup> Megjithëse këtë vit qëndron e parafundit sa i përket publikimit të aktgjykimeve, kjo gjykatë ka shënuar rritje të theksuar (57 %) të publikimit në krahasim me vitin 2020<sup>15</sup>, kur kjo gjykatë kishte publikuar gjithsej 1,390 aktgjykime.

Publikimi i aktgjykimeve nga kjo gjykatë gjatë periudhës janar - dhjetor 2021 është paraqitur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.

FIGURA 22 Niveli i publikimit të aktgjykimeve në Gjykatën Themelore të Pejës gjatë periudhës janar - dhjetor 2021



<sup>14</sup> Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë, nga databaza e FOL janë larguar 8 aktgjykime, për shkak së, një pjesë e tyre janë publikuar nga dy herë, ndërkaq për pjesën tjetër janë publikuar vendime të tjera që nuk do të duhej të publikoheshin.

<sup>15</sup> Raporti për Publikimin e Aktgjykimeve janar-dhjetor 2020, Lëvizja FOL

Kontribut në arritjen e këtij niveli të publikimit kanë dhënë edhe degët e kësaj gjykate. **Dega e Deçanit** gjatë kësaj periudhe kishte publikuar 368 aktgjykime, **Dega e Istogut** 328 aktgjykime, ndërsa **Dega e Klinës** 290 aktgjykime.

Ky nivel i publikimit të degëve të Gjykatës Themelore të Pejës për çdo muaj gjatë kësaj periudhe është paraqitur edhe në tabelën e mëposhtme.




**FIGURA 23**

Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Degët e Gjykatës Themelore të Pejës gjatë periudhës janar - dhjetor 2021


Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara, 1,389 aktgjykime janë të natyrës penale (63%), ndërsa 799 sosh janë të natyrës civile (37%). Lloji i aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë është përshkruar edhe në grafikën e mëposhtme.





Nga të gjitha aktgjykimet e publikuara, ne kemi evidentuar vetëm 10 aktgjykime të korrupsionit dhe 44 aktgjykime të dhunës me bazë gjinore.

Gjykata Themelore e Pejës gjatë kësaj periudhe, njëjtë sikurse në vitin paraprak, nuk kishte publikuar asnjë aktgjykim në gjuhën serbe. Në figurën e mëposhtme është shfaqur në mënyrë grafike gjuha në të cilën janë publikuar aktgjykimet e Gjykatës Themelore të Pejës.




Sa i përket fshehjes së të dhënave personale, edhe kjo gjykatë ka treguar kujdes të shtuar gjatë kësaj periudhe. Gjatë monitorimit, nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë, janë evidentuar 35 aktgjykime të paanonimizuara.

Zbatimi i Vendimit të KGJK-së për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve është arritur deri diku në aktgjykimet e publikuara nga kjo gjykatë. Lëshime në zbatimin e këtij vendimi janë gjetur në 90 aktgjykime të publikuara.

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur niveli i zbatimit të këtij vendimi nga Gjykata Themelore e Pejës gjatë kësaj periudhe.

FIGURA 26

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në aktgjykimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Pejës



Nga analizimi i respektimit të afatit ligjor për publikimin e aktgjykimeve të kësaj gjykate, llogaritur nga dita e shpalljes së tyre, është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 67 ditë për ti publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë e kalon kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e aktgjykimeve.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Themelore të Pejës, duke përfshirë numrin e aktgjykimeve të publikuara nga ana e tyre, gjatë periudhës janar-dhjetor 2021.

FIGURA 27

Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë periudhës janar - dhjetor 2021 në Gjykatën Themelore të Pejës





# Gjykata Themelore e Prizrenit



**2,280**


GJITHSEJ AKTGJYKIME

Gjykata Themelore e Prizrenit, duke përfshirë degët e saj (Dega e Suharekës dhe Dega e Dragashit), gjatë periudhës janar - dhjetor 2021 ka publikuar gjithsej 2,280, përkatësisht 16 % më pak se në vitin 2020 ( 2,738 aktgjykime). Kjo është gjykata e vetme që në vitin 2021 ka publikuar më pak aktgjykime se në vitin e kaluar.

Pra, ndonëse gjatë vitit 2020 kjo gjykatë renditej e dyta për nga niveli i aktgjykimeve të publikuara, gjatë vitit 2021 kjo gjykatë renditet e gjashta.


Në tabelën në vijim, në mënyrë grafike është pasqyruar shkalla e publikimit të aktgjykimeve nga kjo gjykatë gjatë vitit 2021.

FIGURA 28 Niveli i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar - dhjetor 2021



Kontribut të madh në këtë nivel të publikimit të aktgjykimeve në kuadër të kësaj gjykate kanë pasur edhe dy degët e saj. Duhet të theksohet se **Dega e Suharekës** është dega me më së shumti aktgjykime të publikuara, respektivisht me 712 aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe të monitorimit. Ndërsa **Dega e Dragashit** në ueb- faqe ka publikuar gjithsej 109 aktgjykime.

Publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Prizrenit është shfaqur në mënyrë grafike për secilin muaj në tabelën e mëposhtme.



**FIGURA 29**

Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Degët e Gjykatës Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar - dhjetor 2021


Sa i përket natyrës së aktgjykimeve të publikuara, kjo gjykatë prinë me publikimin e aktgjykimeve penale, me 1,879 sosh (82 %), ndërsa ka publikuar vetëm 401 aktgjykime civile (18 %). Lloji i aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë është përshkruar edhe në tabelën e mëposhtme.



Nga aktgjykimet penale të publikuara, vetëm 4 prej tyre kanë të bëjnë me vepra penale të korrupsionit, si dhe 191 me dhunë me bazë gjinore. Pra, kjo është gjykata me më së shumti aktgjykime të publikuara të dhunës me bazë gjinore, ndërsa numri i aktgjyimeve të publikuara në lidhje me veprat penale të korrupsionit vazhdon të jetë i ulët.

Sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar aktgjykimet, duhet të theksohet se gjatë vitit 2021, njëlloj sikurse në vitin e kaluar, nuk është publikuar asnjë aktgjykim në gjuhën serbe. Pra të gjitha aktgjykimet e Gjykatës Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar - dhjetor 2021 kanë qenë të publikuara në gjuhën shqipe.

Gjuha në të cilën janë publikuar aktgjykimet e Gjykatës Themelore të Prizrenit në mënyrë grafike është paraqitur në figurën e mëposhtme.



Sa i përket fshehjes së të dhënave personale në aktgjykimet e publikuara gjatë këtij viti, në 140 aktgjykime janë evidentuar lëshime në publikimin e tyre. Pra kjo është gjykata me më së shumti lëshime sa i përket fshehjes së të dhënave personale, por megjithatë është vërejtur progres në raport me vitin 2020, ku ishin evidentuar 318 aktgjykime të paanonimizuara.<sup>16</sup>


<sup>16</sup> Në disa prej këtyre aktgjyimeve, edhe pse janë fshehur të dhënat personale, ato kanë qenë lehtë të identifikueshme, prandaj edhe janë renditur në kuadër të aktgjyimeve të paanonimizuara.

Edhe Vendimi i Këshillit Gjyqësor për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve është zbatuar relativisht në aktgjykimet e publikuara të kësaj gjykate. Nga të gjitha aktgjykimet e publikuara nga kjo gjykatë gjatë kësaj periudhe, lëshime në zbatimin e këtij vendimi janë vërejtur në 115 aktgjykime, apo në 5 % të tyre .

Në grafikonin e mëposhtëm është përshkruar niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në aktgjykimet e Gjykatës Themelore të Prizrenit, për çdo muaj.

**FIGURA 32**

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në aktgjykimet e publikuara gjatë vitit 2021 nga Gjykata Themelore e Prizrenit




Nga analizimi i respektimit të afatit ligjor për publikimin e aktgjykimeve të Gjykatës Themelore të Prizrenit llogaritur nga data e shpalljes së tyre në ueb faqen e KGJK-së, është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 63 ditë për ti publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se edhe kjo gjykatë e ka kaluar kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e aktgjykimeve.

Gjyqtarët të cilët kanë publikuar më së shumti aktgjykime në Gjykatë Themelore të Prizrenit, duke përfshirë edhe numrin e aktgjykimeve të publikuara nga ana e tyre, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

**FIGURA 33**

Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar - dhjetor 2021





# Gjykata Themelore e Ferizajt



**2,509**


GJITHSEJ AKTGJYKIME

Gjykata Themelore e Ferizajt, duke përfshirë Degën e Kaçanikut dhe atë të Shtërpcës, gjatë periudhës janar–dhjetor 2021 ka publikuar gjithsej 2,509 aktgjykime<sup>17</sup>. Publikimi i aktgjykimeve nga kjo gjykatë është rritur dukshëm në krahasim me vitin paraprak (janar–dhjetor 2020), kur kjo gjykatë kishte publikuar 20 % më pak aktgjykime, përkatësisht 1,937 aktgjykime. Për nga niveli i publikimit të aktgjykimeve gjatë vitit 2021, kjo gjykatë renditet e katërta.

Në figurën e mëposhtme është shfaqur në mënyrë grafike publikimi i aktgjykimeve për çdo muaj nga kjo gjykatë, gjatë periudhës janar–dhjetor 2021.

FIGURA 34

Niveli i publikimit të aktgjykimeve për çdo muaj nga Gjykata Themelore e Ferizajt gjatë periudhës janar–dhjetor 2021



<sup>17</sup> Në këtë numër nuk janë përfshirë edhe 9 aktgjykime, për shkak se disa prej tyre janë evidentuar të përsëritura, ndërsa në disa, përmbajtja e aktgjykimeve të bashkangjitura nuk përkonte me aktgjykimet e listuara në ueb-faqe.

Edhe degët e kësaj gjykate kanë publikuar numër relativisht të madh të aktgjykimeve. **Dega e Kaçanikut** gjatë kësaj periudhe ka publikuar 489 aktgjykime, ndërsa **Dega e Shtërpcës** ka publikuar 148 aktgjykime.

Në tabelën e më poshtme në mënyrë grafike është shfaqur publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Ferizajt, për çdo muaj.

	📍 Kaçanik	📍 Shtërpcë
Janar	26	0
Shkurt	30	4
Mars	35	7
Prill	12	1
Maj	51	10
Qershor	65	14
Korrik	51	20
Gusht	52	18
Shtator	50	16
Tetor	36	20
Nëntor	33	16
Dhjetor	48	22

**FIGURA 35** Publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Ferizajt gjatë periudhës janar - dhjetor 2021

Gjykata Themelore e Ferizajt gjatë periudhës së monitorimit ka publikuar dukshëm më shumë aktgjykime të natyrës penale, sesa civile. Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve, 999 aktgjykime janë të natyrës civile (40%), ndërsa 1,510 aktgjykime janë të natyrës penale (60%).


Në tabelën e mëposhtme është shfaqur lloji i aktgjykimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe nga Gjykata Themelore e Ferizajt.





Nga të gjitha aktgjykimet penale të publikuara nga kjo gjykatë, 9 prej tyre janë për veprat penale të korrupsionit dhe 144 aktgjykime të dhunës me bazë gjinore. Pra edhe kjo gjykatë ka numër të madh të aktgjykimeve të publikuara në lidhje me dhunën me bazë gjinore, ndërsa numri i aktgjykimeve në lidhje me veprat penale të korrupsionit vazhdon të jetë i ulët.


Sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar këto aktgjykime, kjo gjykatë gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 ka publikuar 195 aktgjykime në gjuhën serbe apo 8 %, ndërsa 2,314 aktgjykime tjera në gjuhën shqipe (92 %). Gjuha në të cilën janë publikuar aktgjykimet e Gjykatës Themelore të Ferizajt është paraqitur edhe në tabelën e mëposhtme.



Gjykata Themelore e Ferizajt bashkë me degët e saj është ndër gjykatat me më së shumti lëshime të evidentuara në lidhje me zbatimin e Vendimit të KGJK-së për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve. Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar 228 aktgjykime në të cilat nuk është respektuar forma, apo 9 % të të gjitha aktgjykimeve, ndërsa në pjesën tjetër prej 2,281 aktgjykimesh, ky vendim është zbatuar në tërësi.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Ferizajt.

**FIGURA 38** Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Ferizajt



Gjatë kësaj periudhe të monitorimit, në aktgjykimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Ferizajt janë evidentuar 29 aktgjykime pa fshehjen e të dhënave personale, ndërsa aktgjykimet tjera kanë qenë të anonimizuar në tërësi.

Nga analizimi i respektimit të afatit ligjor për publikimin e aktgjykimeve në ueb-faqen e KGJK-së nga dita e shpalljes së tyre, është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 53 ditë për ti publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë aktgjykimet i publikon brenda kohës së paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e tyre.

Në tabelën e mëposhtme janë renditur gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 nga Gjykata Themelore e Ferizajt.

**FIGURA 39** Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara nga Gjykata Themelore të Ferizajt gjatë periudhës janar - dhjetor 2021





# Gjykata Themelore e Gjilanit




## 1,221

GJITHSEJ AKTGJYKIME

Gjykata Themelore e Gjilanit, duke përfshirë tri degët e saj (Degën e Kamenicës, Vitisë dhe të Novobërdës) është gjykata me më së paku aktgjykime të publikuara gjatë periudhës janar - dhjetor 2021. Kjo gjykatë ka publikuar gjithsej 1,221 aktgjykime<sup>18</sup>, numër ky që është ngritur për 6 % në raport me vitin paraprak (2020), kur kjo gjykatë kishte publikuar 1,147 aktgjykime<sup>19</sup>. Pavarësisht kësaj rritjeje, gjatë kësaj periudhe kjo gjykatë renditet e fundit sa i përket nivelit aktgjykimeve të publikuara.

Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga kjo gjykatë gjatë periudhës janar - dhjetor 2021 është paraqitur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.

FIGURA 40 Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Gjilanit gjatë periudhës janar - dhjetor 2021




<sup>18</sup> Në këtë numër të publikimit nuk janë përfshirë edhe 13 aktgjykime, për shkak se disa prej tyre kanë qenë aktgjykime të përsëritura, ndërsa tek tjetra, numrat e rasteve të listuara në ueb-faqen e KGJK-së nuk përkojnë me aktgjykimet e bashkangjitura.

<sup>19</sup> Për më tepër, shih: Raporti për publikimin e aktgjykimeve, Lëvizja FOL, 2021

Duhet të theksohet se degët e Gjykatës Themelore të Gjilanit kanë vazhduar të publikojnë numër të vogël të aktgjykimeve. **Dega e Vitisë** gjatë kësaj periudhe ka publikuar 111 aktgjykime, **Dega e Kamenicës** 97 aktgjykime, ndërsa **Dega e Novobërdës** ka publikuar 29 aktgjykime.

Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga degët e kësaj gjykate për çdo muaj, është shfaqur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.



**FIGURA 41** Niveli i publikimit të aktgjykimeve në vitin 2021 nga degët e Gjykatës Themelore të Gjilanit


Pjesa më e madhe e aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë, apo 759 aktgjykime, janë të natyrës civile (62 %). Ndërsa pjesa tjetër prej 462 aktgjykimesh janë të natyrës penale (38 %). Pra kjo është gjykata e vetme që ka të publikuara dukshëm më shumë aktgjykime të natyrës civile, se sa penale.

Lloji i aktgjykimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe nga kjo gjykatë mund të shihet edhe në grafikën e mëposhtme.



Nga të gjitha lëndët e natyrës penale të publikuara në ueb-faqen e KGJK-së, FOL ka evidentuar 3 aktgjykime të korrupsionit dhe 27 aktgjykime me bazë në dhunë gjinore.

Nga të gjitha aktgjykimet e publikuara gjatë kësaj periudhe, vetëm 34 prej tyre janë të publikuara në gjuhën serbe (3%), ndërsa pjesa tjetër në gjuhën shqipe. Gjuha në të cilën janë publikuar aktgjykimet e kësaj gjykate është paraqitur në mënyrë grafike edhe në tabelën e mëposhtme.




Gjatë monitorimit është evidentuar se kjo gjykatë ka publikuar 48 aktgjykime pa fshehjen e të dhënave personale subjekteve që kërkohet në bazë të udhëzimit administrativ.

Gjatë monitorimit ne kemi evidentuar 110 aktgjykime në të cilat ka pasur lëshime në zbatimin e Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve. Niveli i zbatimit të këtij vendimi në mënyrë grafike është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

**FIGURA 43**

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në aktgjykimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Gjilanit




Nga analizimi i respektimit të afatit ligjor për publikimin e aktgjykimeve të Gjykatës Themelore të Gjilanit në ueb faqen e KGJK-së llogaritur nga dita e shpalljes, është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 75 ditë për ti publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë e kalon dukshëm kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e aktgjykimeve.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara nga Gjykata Themelore e Gjilanit gjatë periudhës janar-dhjetor 2021.

**FIGURA 44**

Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjilanit gjatë periudhës janar - dhjetor 2021





# Gjykata Themelore e Gjakovës



**2,446**

GJITHSEJ AKTGJYKIME


Gjykata Themelore e Gjakovës, duke përfshirë Degën e Rahovecit dhe atë të Malishevës, gjatë kësaj periudhe në ueb-faqen zyrtare ka publikuar gjithsej 2,446 aktgjykime<sup>20</sup>.

Ky numër i publikimit është rritur dukshëm në krahasim me vitin 2020 (40 %) kur kjo gjykatë kishte publikuar 1,742 aktgjykime. Me këta numra statistikore shihet se ka një avancim të dukshëm të publikimit nga kjo gjykatë, edhe përkundër faktit se gjatë këtij viti renditet e pesta sa i përket nivelit të publikimit të aktgjykimeve në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së.

Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Gjakovës për secilin muaj të kësaj periudhe është shfaqur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.

FIGURA 45


Niveli i publikimit të aktgjykimeve për çdo muaj nga Gjykata Themelore e Gjakovës, gjatë periudhës janar-dhjetor 2021



<sup>20</sup> Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara janë larguar 6 aktgjykime, për shkak se disa kanë qenë aktgjykime të përsëritura, ndërsa tek disa numri i aktgjykimeve të listuara në ueb-faqen e KGJK - së nuk përkon me numrin e aktgjykimeve të bashkangjitura.

Edhe degët e kësaj gjykate kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e publikimit të aktgjykimeve në kuadër të kësaj gjykate. Gjatë kësaj periudhe, **Dega e Malishevës** ka publikuar 408 aktgjykime, ndërsa **Dega e Rahovecit** 702 aktgjykime.

Në tabelën e mëposhtme në mënyrë grafike është pasqyruar publikimi i aktgjykimeve të degëve të Gjykatës Themelore të Gjakovës gjatë kësaj periudhe.




**FIGURA 46**

Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Degët e Gjykatës Themelore të Gjakovës gjatë periudhës janar - dhjetor 2021.

Sa i përket llojit të aktgjykimeve të publikuara, numri më i madh i tyre janë të natyrës penale, respektivisht 1,412 aktgjykime të kësaj natyre (58 %), ndërsa 1,034 aktgjykime janë të natyrës civile (42 %).


Lloji i aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Gjakovës është paraqitur edhe në grafikun e mëposhtëm.





Nga aktgjykimet penale, gjatë kësaj periudhe kjo gjykatë ka publikuar vetëm 6 aktgjykime të korrupsionit dhe 177 aktgjykime të dhunës me bazë gjinore.

Edhe në Gjykatën Themelore të Gjakovës të gjitha aktgjykimet janë publikuar në gjuhën shqipe. Në figurën e mëposhtme është paraqitur gjuha e publikimit të aktgjykimeve të kësaj gjykate.




Sa i përket fshehjes së të dhënave personale të aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë, gjatë kësaj periudhe janë evidentuar 23 aktgjykime të paanonimizuara, ndërsa për pjesën tjetër të aktgjykimeve fshehja e të dhënave personale është bërë në tërësi.

Vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve është zbatuar në pjesën më të madhe të aktgjykimeve të publikuara nga kjo gjykatë. Lëshime në zbatimin e këtij vendimi janë evidentuar vetëm në 29 aktgjykime të publikuara. Zbatimi i këtij vendimi nga kjo gjykatë është paraqitur në mënyrë grafike edhe në tabelën e mëposhtme.

**FIGURA 49**

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në aktgjykimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Gjakovës.



Nga analizimi i respektimit të afatit ligjor për publikimin e aktgjykimeve të Gjykatës Themelore të Gjakovës në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së, llogaritur nga dita e shpalljes së tyre, është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 49 ditë për t'i publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se edhe kjo gjykatë aktgjykimet i publikon në kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e aktgjykimeve.

Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjakovës, përfshirë numrin e aktgjykimeve të publikuara nga ana e tyre, është paraqitur në grafikën e mëposhtme.

**FIGURA 50**

Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjakovës gjatë periudhës janar – dhjetor 2021.



# Rekomandime

Bazuar në të gjeturat e këtij raporti monitorues, rekomandimet në vijim shihen si të domosdoshme për përmirësimin e ngecjeve të evidentuara në publikimin e aktgjykimeve. Këto rekomandime janë:

- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të monitoroj gjykatat mbi nivelin e zbatimit të të gjitha rregulloreve dhe vendimeve të KGJK-së, duke përfshirë edhe Vendimin për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve. Në të njëjtën kohë, KGJK duhet të kërkoj nga kryetarët e gjykatave që të raportojnë mbi arsyet e mos zbatimit të rregulloreve dhe vendimeve në fjalë.
- Të shmanget publikimi i aktgjykimeve në të cilat përfshihen personat e mitur në çfarëdo cilësie, aktgjykimet nga kontestet martesore dhe llojet e tjera të aktgjykimeve dhe aktvendimeve që përjashtohen nga publikimi, të parapara në Udhëzimin Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara.
- Të përditësohet ueb-faqja e KGJK-së me lajme dhe njoftime të reja, të rëndësishme për publikun, duke përfshirë këtu edhe raportet statistikore në lidhje me aktgjykimet e publikuara për çdo muaj.
- Çdo aktgjykim para publikimit duhet të rishikohet nga zyrtarët për informim sa i përket harmonizimit të aktgjykimet me Udhëzimin Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara si dhe nëse është arritur mbrojtja e të dhënave personale në tërësi.
- Të rritet publikimi i aktgjykimeve të keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar.
- Aktgjykimet të publikohen me kohë në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së, e jo të publikohen tërësisht në ditën e fundit të muajit.
- Të respektohet afati prej 60 ditësh për publikimin e aktgjykimeve në ueb-faqen e KGJK-së nga dita e shpalljes, i paraparë në Ligjin për Gjykatat.
- Secila lëndë ta ketë numrin unik të lëndës. Gjatë monitorimit, FOL ka hasur edhe në aktgjykime me numra identik të lëndëve, e të cilat në përmbajtje kanë qenë të ndryshme.
- Çdo aktgjykim të ketë numrin e njëjtë të lëndës si në ueb-faqen e KGJK-së, ashtu edhe në përmbajtje të aktgjykimet.
- Të gjitha aktgjykimet të publikohen në formatin PDF.

# Burimet:

- *Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Prill, 2008.*
- *Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Tetor, 2013.*
- *Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji (nr. 06/L-054) për Gjykatat, Dhjetor, 2018.*
- *Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji (nr.04/L-032) për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Gjykatat.*
- *Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ (02/2016) për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve të Plotfuqishme, Shkurt 2016.*
- *Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ (04/2019) për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara, Dhjetor, 2019.*
- *Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ nr. 01.2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 04/2019 për publikimin e aktgjykimeve të përpunuara.*
- *Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Shabllonet Standarde të Aktgjykimeve–Vëllimi 1, 2018.*
- *Lëvizja FOL, Raport mbi Monitorimin e Publikimit të Aktgjykimeve gjatë periudhës janar–dhjetor 2020.*

